



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Zhvillimit Rajonal  
Ministarstvo za Regionalni Razvoj  
Ministry of Regional Development

Prishtinë, datë, 14.02.2023

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, duke marrë parasysh nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, NR. 7/01 Mars 2019) bazuar në shtojcën 15 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 04/2021 dhe Rregulloren nr. 03/2022, Ligjin nr. 08/L-193 mbi ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, Planin e Punës së MZHR-së për vitin 2023, Udhëzuesin për Aplikonte si dhe bazuar në nenin 12 të Rregullores nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit të OJQ-ve, nxjerr këtë:

#### V E N D I M

Për shpalljen e Thirrjes Publike për mbështetje financiare publike për projekte /programe të organizatave jo-qeveritare në fushën e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

##### I

1. Për implementimin e Thirrjes Publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve.

2. Mbështetje financiare publike për projektet /programet e OJQ-ve do të ofrohet nga Buxheti i MZHR-së, kodi i organizates buxhetore 221 në kuandër të kategorisë ekonomike Subvencione dhe Transfere - kodi ekonomik 21200.

##### II

1. Mjetet e përmendura në nenin I do të shpërndahen në bazë të Thirrjes Publike për Financimin e Projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### III

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1 Teksti i Thirrjes publike;
- 1.2 Udhëzimet për aplikantët;
- 1.3 Formularët e aplikimit;
- 1.4 Forma për vlersimin e cilësisë së projekteve;
- 1.5 Format për raportimin e zbatimit të projektit.

2. Formularët e aplikimit referuar në praragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1 Forma e përshkrimit të programit apo projektit;
- 2.2 Forma e buxhetit të programit apo projektit;
- 2.3 Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta;
- 2.4 Deklaratat e Partneritetit (nëse është e aplikushme);

5. Forma e deklaratës së programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike;
6. Formulari për Deklaratën mbi aktivitetet e përshkruara të programit / projektit.

3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 3.1 Forma e Kontratës për financimin e programit apo projektit;
- 3.2 Formulari për përgaditjen e raportit narrativ për projektin apo programin;
- 3.3 Formulari për përgaditjen e raportit financiar të programit apo projektit.

#### IV

1. Thirrje publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të MZHR-së: <https://mzhr.rks.net/language/sq/>.

#### V

1. Në përputhje me Rregulloren për Kriteret, Standardet dhe Procedurat Financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, MZHR do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

3. Antarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me rregulloren financiare publike të OJQ-ve

#### VI

1. Pasi të merret Vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilave i plotësojnë kushtet për financim, Udhëheqësi i institucionit do të nxjerr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve / programeve të OJQ-ve.

2. MZHR do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të Kontratave.

3. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Departamenti për Zhvillim Rajonal.

#### VII

1. Ky vendim hynë në fuqi pas nënshkrimit.

Besim Kamberaj  
  
Zv. Sekretar i Përgjithshëm

Vendimi i'u dërgohet:

- Ministrit të MZHR-së;
- Udhëheqësit të DZHR-së;
- Arkivit të MZHR-së